



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:092167
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05722776

P.nr.2653/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Bujar Ahmeti dhe bashkëpunëtorin profesional Bekim Telaku, në çështjen penale kundër të pandehurit F.Z., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1512/20 të datës 06.05.2021, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar publik me datë 14.05.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Kushtrim Zeka dhe të pandehurit F.Z., me datë 15.05.2024 publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datë 22.05.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

F.Z., nga babai S., dhe nëna Z., mbiemri i vajzërisë se nënës A., i lindur me datë ., në P., i pa martuar, punon, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 10.11.2020 rreth orës 19:00, në rrugën "Migjeni", i pandehuri F.Z., pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të llojit marihuana, në atë mënyrë që njësi patrullues duke vepruar sipas autorizimeve policore ka ndaluar automjetin Fiat, ngjyrë të kaltër, me targa ... të cilën po e drejtonte A.H. në të cilën gjendej i pandehuri F.Z. si pasagjer dhe gjatë kontrollimit tek i njëjti është gjetur një qese me bari ngjyrë e gjelbër të dyshuar si substancë narkotike të llojit marihuana, me peshë rreth 1.8 gram, një makinë për bluarje të narkotikut dhe një pako letra rrizlle dhe pas ekzaminimit të mostrave të dëshmive #“1.., sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike nga AKF është konstatuar se këto dëshmi përmbajnë Kanabis (Marihuana) që përmbajnë Tetrahydrokanabinol (TCH), me peshë neto të përgjithshme të përafërt 1.60 ± 0.0001 gram.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale *Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2* lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prandaj, kjo gjykatë në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39 par. 1 pika 1.1, 40 par. 1 pika 1.3, 43, 69, 70, nenit 269 par. 2 lidhur me par.1 dhe 3 të KPRK-së, dhe nenit 242, 364, si dhe 449 të KPP-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 400 € (katërqind Euro), të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së, ashtu që dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 € (njëzet euro) të gjobës.

Në mbështetje të nenit 276 par. 1 dhe 2 të KPP-së, si dhe nenit 269 par. 3 të KPRK-së, **URDHËROHET KONFISKIMI** i përhershëm i sendit dhe atë një qese e vogël me substancë narkotike të llojit Marihuanë me peshë të përgjithshme prej 1.60 gram, një makinë për bluarje të narkotikut dhe një pako letra rrizlle. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kjo substancë narkotike me sendet tjera, duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me institucione tjera relevante, sipas procedurave standarde në fuqi.

I pandehuri obligohet që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzet (20) Euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj me numër PP.II.nr.1512/20 të datës 06.05.2021 të pandehurin F.Z. e ka akuzuar për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata pas vlerësimit të kompetencës lëndore dhe territoriale dhe duke vepruar sipas aktakuzës, me datë 14.05.2024 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilin seancë prezent ishin Prokurorja e Shtetit Kushtrim Zeka dhe i pandehuri F.Z..

Gjyqtari i vetëm gjykues e ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat konform nenit 241 par. 1 të KPP-së. Pas kësaj, Prokurori i Shtetit e ka lexuar aktakuzën dhe pasi gjyqtari u bind se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, bazuar në dispozitën e nenit 241 par. 4 të KPP-së të njëjtit i ofroi mundësinë që të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm.

Në seancën e shqyrtimit fillestar i pandehuri pas sqarimeve të nevojshme nga ana e gjykatës, deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, se është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat e këtij pranimi, duke shtuar se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i ri dhe ka dy vite që nuk konsumon narkotik, tani është punësuar dhe të ardhurat e vetme në familje varen nga puna e tij, i premtonte gjykatës se në të ardhmen nuk do të bie

ndesh me ligjin, ka kërkuar falje, njëherit i ka propozuar gjykatës që t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Pasi që i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë, konform nenin 242 par.5 të KPP-së gjyqtari ka marrë mendimin e Prokurorit të Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, i cili ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitës ligjore të nenit 242 të KPP-së dhe po ashtu është në harmoni të plotë edhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, me të cilat vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, andaj i ka propozuar gjykatës që ta miratoj pranimin e fajësisë, të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit. Ndërkaq me rastin e shqyrtimit të dënimit, ka propozuar që si rrethanë lehtësuese të merret parasysh pranimin e fajësisë, ndërsa rrethanë rënduese të merret rrezikshmëria shoqërore.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me pranimin e fajësisë.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri dhe erdhi në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPP-së dhe në pajtim me faktet dhe provat që përmban aktakuza, njëherit vlerësoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe mbështetet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike, po ashtu gjykata sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 251 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme. Pasi gjyqtari i vetëm gjykuese u bind se i pandehuri e ka kuptuar natyrën, benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe pasi që konstatoi se pranimi është në përputhje me nenin 242 par. 2 të KPP-së, me aktvendim e aprovoi pranimin e fajësisë së të pandehurit, për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave në këtë çështje penale, por shqyrtimi fillestar ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjendja faktike e vërtetuar.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat të cilat i janë bashkangjitur shkresave të lëndës, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e të pandehurit formohen të gjitha elementet e veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, të përshkruar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, dhe për këtë gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin me gjobë, i cili dënim është i përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike.

Rrethanat me rastin e matjes dhe lartësisë së dënimit.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë lehtësuese vlerësoi faktin e pranimit të fajësisë në këtë fazë të procedurës nga i pandehuri për veprën penale e cila i vihet në barrë, kërkim faljen, bashkëpunimi i tij me gjykatën, si dhe premtimin se më nuk do të bie ndesh me ligjin, ndërsa rrethana rënduese gjykata mori për bazë shkallën përgjegjësisë penale të pandehurit, si dhe faktin se veprat penale të kësaj natyre janë të shprehura e në të tendencë të rritjes së tyre.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të elaboruara si më lartë, të njëjtit i shqiptoj dënimin me gjobë sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimit. Gjykata përkitazi me dënimin me gjobë mori për bazë pranimin e fajësisë, premtimin se më nuk do të përsërisë këtë veprë penale dhe kërkim faljen e të njëjtit në seancën e shqyrtimit fillestar për veprën e kryer penale. Gjykata me këtë dënim konsideron se i pandehuri e ka kuptuar rëndësinë e veprimeve të dëmshme dhe mbi bazën e këtyre rrethanave, gjyqtari është i bindur se dënimi i shqiptuar me gjobë është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit, duke marrë parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, kështu gjykata vlerëson se me shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e veprës penale dhe të kryesit, po ashtu ky dënim do të shërbej në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale), si dhe do të arrihet qëllimi që t'i parandaloj edhe personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi konfiskim

Gjykata në mbështetje të nenit 276 par. 1 dhe 2 të KPP-së, si dhe nenit 269 par. 3 të KPRK-së, ndaj të pandehurit ka urdhëruar edhe konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike dhe të sendeve tjera, më afër të përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për faktin se i pandehuri nuk ka pasur autorizim për posedimin e narkotikut. Në anën tjetër, substanca narkotike e cekur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bënë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyra automatike, andaj nga këto arsye gjykata ka vendosur ta konfiskoj përherë dhe substanca narkotike si e tillë ka urdhëruar që të shkatërrohet. Andaj, gjykata vlerëson se në këtë rast plotësohen kushtet dhe kërkesat ligjore për konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike sipas nenit 269 par.3 KPRK-së, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm të sendeve të tilla.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës penale, në kuptim të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPP-së, obligoi të pandehurin që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet euro) €. Po ashtu, konform nenit 36 par. 3 nën par. 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro) në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.2653/21 datë 22.05.2024

Bashkëpunëtor Profesional
Bekim Telaku

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Bujar Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditëve prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.